VENDIM
Nr. 52, datë 29.1.2020

PËR FINANCIMIN E KONTRIBUTIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR PROJEKTIN "SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN", QË DO TË FINANCOHET NGA BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ligjit nr. 63/2019, "Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin "Shtrati i Lumit Lana-zhvillim urban", të ligjit nr. 64/2019, "Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin 'Shtrati i Lumit Lana- zhvillim urban'", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin në vlerën 1 590 000 000 (një miliard e pesëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë, të bashkëfinancimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të projektit "Shtrati i Lumit Lana – zhvillim urban", që do të financohet nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI).

2. Vlera prej 1 590 000 000 (një miliard e pesëqind e nëntëdhjetë milionë) lekësh, e cila do të përdoret për qëllimin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të përballohet 50% nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe 50% nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, dhe do të shtrihet në tri vite, si më poshtë vijon:

a) 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekë, për vitin 2021;

b) 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekë, për vitin 2022;

c) 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekë, për vitin 2023.

3. Efekti financiar, sipas shkronjës "a", të pikës "2", të këtij vendimi, prej 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekësh, do të parashikohet:

a) 265 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, në projektbuxhetin e vitit 2021 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zërin "Kosto lokale";

b) 265 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, në projektbuxhetin e vitit 2021 të Bashkisë Tiranë.

4. Efekti financiar, sipas shkronjës "b", të pikës "2", të këtij vendimi, prej 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekësh, do të parashikohet:

a) 265 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, në projektbuxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zërin "Kosto lokale";

b) 265 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, në projektbuxhetin e vitit 2022 të Bashkisë Tiranë.

5. Efekti financiar, sipas shkronjës "c", të pikës "2", të këtij vendimi, prej 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekësh, do të parashikohet:

a) 265 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, në projektbuxhetin e vitit 2023 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zërin "Kosto lokale";

b) 265 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, në projektbuxhetin e vitit 2023 të Bashkisë Tiranë.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe